

VENDIM
Nr. 132, datë 2.7.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” SHPK
NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 979/12 prot., datë 1.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GreeNNat Solar Park Ballsh’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 979 prot., datë 23.4.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 80, datë 2.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 3.5.2024 dhe 4.5.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.6.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen e internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1481 prot., datë 6.6.2024, ka njoftuar MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit për shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. Ndërsa me shkresën nr. 979/3 prot., datë 17.5.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar apo plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria, me shkresat nr. 979/4 prot., datë 29.5.2024, nr. 979/5 prot., datë 31.5.2024, nr. 979/7 prot., datë 19.6.2024, nr. 979/8 prot., datë 26.6.2024 dhe nr. 979/11 prot., datë 28.6.2024, ka përcjellë dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Po ashtu, nga analizimi i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin, në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “GreeNNat Solar Park” sh.p.k.:

- ka marrë miratimin për ndërtimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative

Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, nga shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 6, datë 11.1.2023;

- ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë kontratën nr. 31 rep., nr. 13/5 kol., datë 27.1.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier nga shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k.”;

- ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” marrëveshjen nr. 1966/2 prot., datë 17.4.2020, për lidhjen e parkut fotovoltaike me rrjetin e transmetimit të OST sh.a.;

- është pajisur me vendim për VNM-në paraprake, lëshuar më datë 24.6.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaike ‘GreeNNat Solar Park’, 100 mw”.

- Në rast se pas nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë, do të ndryshojë mënyra e financimit të projektit nga sa parashikuar në planin e biznesit, shoqëria mbart detyrimin për të depozituar këtë plan të rishikuar në ERE.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret, shoqëria ka informuar se jetëgjatësia e paneleve është 25 vjet, ndaj ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës.

- Në pikën 1, germa “d”, të VKM-së nr. 6, datë 11.1.2023, përcaktohet se: “Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të parkut fotovoltaike do të jetë brenda 60 (gjashtëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi (pra brenda datës 11.1.2028) dhe në nenin 9, pika 2 të kontratës së nënshkruar me MIE-n parashikohet se ky afat do jetë sipas përcaktimeve të VKM-së.”.

- Shoqëria ka parashikuar operimin e centralit të saj në datën 1.6.2028, por vlerësohet që afati 25-vjeçar i licencës për prodhimin e energjisë elektrike të fillojë nga data e parashikuar nga VKM-ja për operimin e centralit, pra 11.1.2028.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 11.1.2028.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti